




LIGJI

Nr.9154, datë 06.11.2003

“PËR ARKIVAT ”

...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.



Tiranë, më 16.12.2011

Përmbledhje

- ✳️ **LIGJ Nr.9154, date 06.11.2003 “Per Arkivat”**
- ✳️ VKM Nr.390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”
- ✳️ VKM Nr.761, date 19.11.2004 “Per krijimin e arkivit qendror per sistemimin, ruajtjen dhe shfrytezimin e dokumentacionit te periudhes se sigurimit prane institutit te sigurimeve shoqerore”
- ✳️ VKM Nr.157, datë 25.3.2005 “Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të këshillit të lartë të arkivave”
- ✳️ VKM Nr. 158, datë 25.3.2005 “Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të komisionit qendror të ekspertizës, pranë drejtorisë së përgjithshme të arkivave”
- ✳️ VKM Nr.160, datë 25.3.2005 “Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të komisionit të përhershëm të ekspertëve, pranë drejtorisë së përgjithshme të arkivave”

LIGJ
Nr.9154, date 06.11.2003

“PER ARKIVAT”

Ne mbështetje te neneve 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I
OBJEKTI DHE PERKUFIZIME

Neni 1

Ky ligj përcakton rregullat baze për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor ne Shqipëri, institucionet qe kryejnë tete shërbim, si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, si pjese e trashëgimisë kombëtare.

Neni 2

Ne këtë ligj, termat e mëposhtëm kane këto kuptime:

1."Arkiva" janë institucionet shtetërore ose joshtetërore te specializuara, qe mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nenstrukturore te institucioneve te administratës shtetërore qendrore e vendore, qe evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vene ne shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre.

2. "Arkiv" është çdo pasuri dokumentare qe ruhet prej institucioneve te përcaktuara ne piken 1 te këtij neni, si dhe çdo pasuri dokumentare e krijuar ose e ruajtur prej subjekteve joshtetërore, juridike fizike private.

3. "Autoritet publik" janë organet përfaqësuese te pushtetit qendror dhe vendor; institucionet e administratës, qendrore dhe vendore te pushteteve kushtetuese; personat juridike dhe fizike, ne masën qe ata përmbushin funksione publike ose ushtrojnë një detyre administrative, sipas ligjeve ne fuqi.

4. "Dokumente me rëndësi historike kombëtare" janë te gjitha aktet qe kane vlere ruajtjeje te përhershme dhe shpallen si te tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për shkak te rëndësisë juridiko-administrative, historike, shkencore dhe kulturore për trashëgiminë e popullit shqiptar.

5. "Dokumente" janë te gjitha aktet e krijuara nga autoritetet publike, gjate ushtrimit te veprimtarisë se tyre ne funksione administrative; aktet e krijuara nga institucionet joshtetërore, si dhe subjektet juridike e fizike private, kur vlerësohen me rëndësi historike kombëtare.

6. "Fondi arkivor kombëtar" është e gjithë pasuria dokumentare, shtetërore e joshtetërore, me vlere ruajtjeje te përhershme ose te përkohshme, ne administrim te arkivave shtetërore a private.

7. "Kërkues" është personi qe ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shërbim arkivor, e cila i është miratuar, me përjashtim te vete personelit te brendshëm te arkivave.

8. "Komunikim" është detyrimi ligjor i arkivave shtetërore për të vënë në dispozicion dhe për t'u shërbyer institucioneve dhe individëve dokumentet që ato ruajnë dhe përmbushja e kësaj përgjegjësie ligjore.

9. "Rrjet arkivor" është tërësia e institucioneve në varësi të drejtpërdrejte, si dhe e atyre që kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, përshkruar sipas nenit 9 të këtij ligji.

10. "Shfrytëzim i arkivave" është mundësia e përdorimit të dokumenteve arkivore, në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe e drejta për shërbim me dokumente për qëllime studimore-shkencore ose për nevojë a vetjake.

KREU II FONDI ARKIVOR KOMBËTAR

Neni 3

1. Fondi arkivor kombëtar është tërësia e dokumenteve të krijuara, të dërguara dhe të pranuar, gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose joshtetërore, të personave juridike e fizike private, pavarësisht nga koha, vendi, pronësia, mënyra e krijimit dhe lloji i tyre, me vlerë historike kombëtare juridike, politike, ekonomike, sociale e kulturore.

2. Emërtimi i dokumenteve, që përbejnë fondin arkivor kombëtar, shpallet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe është i njëzuar në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Neni 4

Në fondin arkivor kombëtar bëjnë pjesë edhe dokumentet e krijuara nga institucionet e administratave shtetërore të huaja, që kanë vepruar në hapësirën historike shqiptare para shpalljes së Pavarësisë, si dhe dokumentet e organizatave, shoqërive dhe personaliteteve shqiptare, që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre jashtë shtetit.

Neni 5

1. Fondi arkivor kombëtar dhe arkivat mbrohen dhe sigurohen nga shteti, sipas kërkesave të këtij ligji.

2. Shteti shqiptar njeh detyrimet për mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare, që rrjedhin nga aktet juridike ndërkombëtare, ku ai është pale nënshkruese.

Neni 6

1. Dokumentet e subjekteve shtetërore e joshtetërore, si dhe të personave juridike e fizike private, që janë bërë pjesë e fondit arkivor kombëtar para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor dhe për arkivat", janë të pakthyeshme, pavarësisht nga mënyra e hyrjes në arkivat shtetërore, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen e pranimit.

2. Dokumentet që përbejnë fondin arkivor kombëtar nuk dalin jashtë vendruajtjes së përhershme, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Në ato raste kur dokumenti del jashtë vendruajtjes, shoqërohet nga një punonjës i autorizuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Pas përfundimit të veprimeve procedurale të domosdoshme, dokumenti kthehet në vendruajtjen e përhershme dhe nëse është e nevojshme përdoret përsëri sipas së njëjtës procedure.

Neni 7

1. Përcaktimi i vlerës dhe i afateve të ruajtjes së dokumenteve të arkivave në veprim të institucioneve shtetërore bëhet nga komisionet e ekspertizës, që funksionojnë pranë këtyre institucioneve. Vendimet e tyre miratohen nga komisionet e ekspertizës, që funksionojnë pranë arkivave respektive të një shkalle më lart, të përshkruar sipas nenit 9 të këtij ligji.
2. Asgjësimi i dokumenteve, që e humbasin vlerën e ruajtjes, bëhet nga institucionet që i kanë ato në administrim, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 8

Institucionet shtetërore ose jashtetërore, si dhe personat juridike e fizike private që kanë dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, janë të detyruara të dërgojnë të dhëna informuese për efekt regjistrimi në arkivat shtetërore respektive, të përshkruar në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligji.

KREU III ORGANIZIMI I RRJETIT ARKIVOR

Neni 9

1. Fondi arkivor kombëtar ruhet, përpunohet, administrohet dhe shërbehet nga rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë.
2. Rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga:
 - a) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
 - b) Arkivi Qendror Shtetëror;
 - c) arkivat shtetërore që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji (Arkivi Qendror i Filmit, Arkivi Qendror Teknik);
 - ç) arkivat shtetërore të sistemit, që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë institucioneve qendrore fondkrijuese;
 - d) arkivat shtetërore vendore;
 - dh) arkivat në veprim të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore;
 - e) arkivat private.
3. Krijimi i arkivave të rinj shtetërore, sipas pikës 2 shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është organi më i lartë i rrjetit arkivor kombëtar. Ajo është institucion qendror në varësi të Kryeministrit.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është person juridik. Ajo ka vulën dhe stemën e vet. Selia e saj ndodhet në Tiranë.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet dhe lirohet nga detyra prej Kryeministrit.

Neni 11

1. Drejtori i Përgjithshëm është titullari i institucionit. Ai kryen këto detyra:

- a) përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave për veprimtarinë e institucionit;
 - b) miraton rregullore, urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim, në mbështetje të legjislacionit arkivor;
 - c) miraton planet vjetore të drejtorive që funksionojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme dhe ato të drejtorive të arkivave shtetërore vendore;
 - ç) përfaqëson arkivat shtetërore të vendit në organizmat dhe institucionet ndërkombëtare ku ato janë anëtarësuar dhe ushtron të drejtën e votës në emër të tyre.
2. Drejtori i Përgjithshëm kryen detyra të tjera të parashikuara nga Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Neni 12

1. Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, drejtuesit, specialistet dhe arkivistet, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohet legjislacioni i Kodit të Punës.
2. Rekrutimi i punonjësve, mënyra e pranimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyra dhe largimit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë në vende pune që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, janë nëpunës në periudhë prove për 1 vit.

Neni 13

1. Në varësi të drejtpërdrejte administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave janë Arkivi Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërore vendore.
2. Arkivat e tjerë, që bëjnë pjesë në rrjetin arkivor kombëtar, të përshkruar në nenin 9 shkronjat "c", "ç", "dh" dhe "e", kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 14

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave funksionojnë: Këshilli i Lartë i Arkivave, Komisioni Qendror i Ekspertizës, Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" dhe Komisioni i Përhershëm i Eksperteve të Vlerësimit të Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare.
2. Këshilli i Lartë i Arkivave harton dhe miraton politikën arkivore dhe strategjinë e zhvillimit të shërbimit arkivor.
3. Komisioni Qendror i Ekspertizës shqyrton dhe miraton listat e dokumenteve për asgjësim, sipas vendimit të propozuar prej komisioneve të ekspertizës, që funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, të cilat i dorëzojnë dokumentet e tyre në Arkivin Qendror Shtetëror.
4. Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" bën deklasifikimin e dokumenteve, që kanë hyrë të klasifikuara në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në arkivat shtetërore vendore, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" .
5. Statusi, rregullat, përbërja dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Arkivave, të Komisionit Qendror të Ekspertizës, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" dhe të Komisionit të Përhershëm të Eksperteve për Vlerësimin e Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 15

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor dhe organizon, drejton e kontrollon zbatimin e njësuar të saj në veprimtarinë e të gjithë rrjetit arkivor të vendit.
2. Për krijimin e normës tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave mbështetet në legjislativën e vendit dhe në aktet e marrëveshjet themelore ndërkombëtare, të pranuar në rang ndërkombëtar, në këtë ligj dhe në Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.
3. Rregullat e miratuara prej kësaj drejtorie, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji, janë të detyrueshme për zbatim në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Neni 16

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ushtron të drejtën e përfaqësimit dhe të votës, në emër të shtetit shqiptar, në organizatat ndërkombëtare ku është anëtarë.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nënshkruan marrëveshje dy ose shumëpalëshe me institucionet respektive të vendeve të tjera për pasurimin e fondit arkivor kombëtar, për publikimin, shkëmbimin e përvojave, përgatitjen dhe kualifikimin e specialisteve.

Neni 17

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, përpunon, administron dhe shërben:

- a) dokumentet që janë trashëguar nga shteti shqiptar nga periudha parashtetërore;
- b) dokumentet që janë krijuar nga institucionet qendrore e vendore të administratës shtetërore deri në vitin 1944;
- c) dokumentet e institucioneve qendrore të administratës shtetërore dhe të organeve udhëheqëse partiake, të krijuara deri në vitin 1991;
- ç) dokumentet e institucioneve qendrore të administratës shtetërore pa kufizim kohor, me përjashtim të atyre që ruhen në arkivat e sistemit ose në arkivat që ruajnë akte të së njëjtës tipologji;
- d) dokumentet që janë krijuar prej institucioneve të tjera shtetërore joqendrore pas vitit 1944, por janë të vetme në llojin e tyre;
- dh) dokumentet që janë krijuar prej subjekteve e personave juridike dhe fizike private, të kaluara në pronësi të shtetit para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat".

Neni 18

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, administron dhe shërben trashëgiminë dokumentare joadministrative, të krijuar në hapësirën shqiptare gjatë shekujve, pavarësisht nga fondkrijuesi, gjuha, alfabeti, përmbajtja apo tipologjia e shkrimit.

Neni 19

1. Arkivat shtetërore, që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji janë Arkivi Qendror i Filmit dhe Arkivi Qendror Teknik.
2. Këta arkiva kontrollojnë zbatimin e këtij ligji dhe japin ndihme metodologjike e profesionale në arkivat vendore, ku ruhen dokumentet e së njëjtës tipologji.

Neni 20

1. Arkivat shtetërore te sistemit funksionojnë pranë këtyre institucioneve: Ministrisë se Mbrojtjes, Ministrisë se Rendit Publik, Ministrisë se Punëve te Jashtme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.
2. Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë dhe ai i Presidentit i administrojnë dokumentet respektive në arkiva që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë tyre.
3. Arkivat shtetërore te sistemit funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, të cilat, sipas Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, janë institucione të pavarura.
4. Arkivi shtetëror i sistemit të drejtësisë (gjykatat e prokuroritë) krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.
5. Arkivat e sistemit funksionojnë sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 21

1. Arkivat shtetërore te sistemit administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e krijuara gjatë veprimtarisë së institucioneve që, sipas ligjit, e dorëzojnë pasurinë arkivore pranë tyre. Ata kontrollojnë zbatimin e ligjit dhe japin ndihme metodike në arkivat e institucioneve shtetërore të varësisë së tyre.
2. Arkivat shtetërore te sistemit janë në varësi administrative të drejtpërdrejte të drejtuesit të institucionit.

Neni 22

1. Arkivat shtetërore vendore administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e arkivave të institucioneve shtetërore vendore dhe të organeve të qeverisjes vendore, që veprojnë brenda njësisë administrative-territoriale përkatëse. Ata kontrollojnë dhe japin ndihme metodike në arkivat e pushtetit vendor dhe të institucioneve shtetërore vendore, që veprojnë në njësinë administrative-territoriale përkatëse.
2. Arkivat shtetërore vendore janë të detyruar të regjistrojnë çdo pasuri dokumentare joadministrative, që ekziston në territorin e njësisë së tyre administrative-territoriale.
3. Këto pasuri i bëhen të ditura menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror.

Neni 23

1. Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore janë pjesë organike e tyre dhe varen drejtpërdrejt nga drejtuesi i institucionit.
2. Në varësi të vëllimit të dokumenteve që krijohen, pranë çdo institucioni shtetëror funksionojnë: sekretaria dhe arkivi, sekretari-arkivi ose punonjësi i ngarkuar me shërbimin në sekretari-arkiv.

Neni 24

Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë:

- a) të evidentojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni;
- b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë;
- c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligji.

KREU IV ARKIVAT PRIVATE

Neni 25

1. Arkivat private e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi licencohen nga Këshilli i Larte i Arkivave me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kriteret për licencim përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.
2. Pasuritë, që administrohen në arkivat private, gëzojnë të njëjtën mbrojtje nga shteti si ato të arkivave publike.

Neni 26

1. Pasuri të arkivave private, për arsye historike ose me interes publik, mund të shpallen dokumentet me rëndësi historike kombëtare. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si dhe arkivi privat kanë të drejtën e nismës, ndërsa të drejtën e vendimit të shpalljes e ka Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
2. Shpallja "dokumente me rëndësi historike kombëtare" e pasurive dokumentare, që ruhen në arkivat private, nuk cenon, kufizon ose ndryshon marrëdhënien e pronësisë.
3. Përfaqësuesi i arkivit privat ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e përcaktimit të dokumenteve në pronësi të tij, të shpallura me rëndësi historike kombëtare. Vendimi për ndryshimin e statusit të dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare merret në të njëjtën formë, me të njëjtën procedurë dhe nga të njëjtat autoritete, si në rastin e shpalljes së tyre si të tilla.

Neni 27

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, kur nis procedurën për shpalljen e dokumenteve në pronësi të arkivave private, si dokumente me rëndësi historike kombëtare, njofton menjëherë pronaret ose përfaqësuesit e këtyre të fundit.
2. Efektet ligjore të vendimit hyjnë në fuqi një ditë pas shpalljes.

Neni 28

1. Dokumentet e arkivave private, që shpallen me rëndësi historike kombëtare nuk kanë afat të parashkrueshem. Shpallja e tyre si të tilla nuk është pengese për transferimin e të drejtës së pronësisë dhe të të drejtave të tjera mbi këto dokumente.

Neni 31

2. Arkivat private, që kanë në pronësi dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në rastin e ndryshimit të pronësisë, janë të detyruara t'i bëjnë të njohur paraprakisht blerësit statusin e dokumenteve të tyre.

Neni 29

1. Asgjësimi i dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në pronësi të arkivave private, është i ndaluar.
2. Asgjësimi i dokumenteve që e kanë plotësuar afatin ligjor të ruajtjes, prona e arkivave private, behet me të njëjtat procedura si për arkivat shtetërore. Ligjshmëria e vendimit për asgjësim miratohet zyrtarisht dhe me shkrim nga autoritetet e arkivave shtetërore përkatës.

Neni 30

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare, ne pronësi te arkivave private, nuk mund te shiten dhe te dhurohen jashtë vendit.

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, ne cilësinë e përfaqësuesit te shtetit shqiptar, gëzon te drejtën e parablerjes se dokumenteve te shpallura me rëndësi historike kombëtare, qe ndodhen ne pronësi te subjekteve private.

2. Kur subjektet private dëshirojnë te shesin dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare, ato duhet te paraqesin pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Arkivave përshkrimin e tyre, ne përputhje me normën e njësuar ne fuqi. Subjekti privat qe ka ne pronësi dokumente te tilla është i detyruar te paraqesë me shkrim te dhënat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, pas këshillimit te te dhënave pershkrimore, te vlerësuar nga Komisioni i Përhershëm i Eksperteve, vendos për dhënien ose jo te lejes për shitjen, si dhe për kushtet e tregtimit te këtyre dokumenteve. Ne çdo rast Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është e detyruar t'i ktheje përgjigje pronarit te dokumenteve brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit te te dhënave pershkrimore për to. Kundër vendimit te dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, personi ka te drejtën e ankimit ne gjykate, sipas Kodit te Procedurave Administrative.

Neni 32

Shteti liron nga detyrimet vjetore fiskale pronaret e arkivave private, qe u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare, ne përputhje me ligjin nr.7892, date 12.12.1994 "Për sponsorizimet".

Neni 33

Arkivat private, qe administrojnë dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare janë te detyruar te bëjnë regjistrimin e tyre ne evidencën e arkivave shtetërore, qendrore ose vendore dhe ne përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore. Regjistrimi i tyre behet jo me vone se një vit nga hyrja ne fuqi e këtij ligji. Me mbarimin e këtij afati, çdo tjetërsim ose shitblerje e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare ne pronësi te tyre është i paligjshëm.

Neni 34

1. Pronaret e arkivave private, qe u dhurojnë ose u shesin arkivave shtetërore dokumente me rëndësi historike kombëtare, gëzojnë te drejtën e pronësisë intelektuale, sipas legjislacionit ne fuqi.

2. Këto te drejta i gëzon çdo subjekt privat për dokumentet e krijuara jashtë funksioneve shtetërore.

Neni 35

1. Kur subjektet shtetërore privatizohen, dokumentet e tyre mbeten prone e shtetit. Institucionet e administratës shtetërore, qe bëjnë privatizimin, janë te detyruara te dorëzojnë paraprakisht ne arkivat shtetërore përkatës, qendrore ose vendore, arkivat e subjekteve shtetërore qe privatizohen.

2. Autoritetet e arkivave shtetërore vendosin për dhënien e pjesshme ose te plote te kopjeve te dokumenteve, qe lidhen me tekniken dhe teknologjinë e prodhimit, pronarit te ri joshtetëror, me kërkesën e këtij te fundit. Shpenzimet e riprodhimit te dokumenteve janë te palës kërkuese.

KREU V **ARKIVAT E NUMERIZUAR**

Neni 36

1. Dokumentet e numerizuara, pavarësisht nga forma e regjistrimit dhe e qarkullimit, kanë vlerë administrative e juridike vetëm nëse janë hartuar e janë ruajtur sipas standardeve të miratuara.
2. Përshkrimi ligjor i dokumentit të numerizuar bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet shtetërore të shërbimit informatik. Ato përgatisin rregulla të detyrueshme për hartimin, evidencimin, qarkullimin, përpunimin tekniko-shkencor, ekspertizën e vlerës së ruajtjes e asgjësimit, si dhe për ruajtjen, dublikimin, riprodhimin dhe legalizimin e dokumenteve të numerizuara. Këto rregulla miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Dokumentet e numerizuara janë të vlefshme si pasuri arkivore nëse janë regjistruar në formë të pandryshueshme që në aktin e krijimit.

Neni 38

Kalimi i dokumentit që është krijuar në bartës material (letër, pergamene) në dokument, në formë të numerizuar, bëhet duke ruajtur njëshmerinë me origjinalin.

Neni 39

Dokumentet e numerizuara ruhen pranë arkivave të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore. Në mbarim të afatit ligjor të ruajtjes pranë tyre, ato dorëzohen në arkivat shtetërore respektive, sipas përshkrimit në nenin 9 të këtij ligji.

Neni 40

Institucionet fondkrijuese të dokumenteve të numerizuara dorëzojnë pranë arkivave përkatës, në të njëjtët bartës që kanë regjistruar dokumentet, edhe mjetet e informimit dhe të kërkimit arkivor.

Neni 41

1. Arkivat e numerizuar janë pjesë e rrjetit arkivor kombëtar. Arkivat e numerizuar I nënshtrohen së njëjtës disipline ligjore për ruajtjen, komunikimin dhe shërbimin.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka të drejtën e përcaktimit të programeve të numerizimit të dokumenteve në institucionet fondkrijuese.

KREU VI **DOREZIMI I DOKUMENTEVE NË ARKIVAT SHTETËRORE**

Neni 42

1. Dokumentet arkivore, në mbarim të afatit të shërbimit operativ pranë arkivave të institucioneve fondkrijuese, dorëzohen nga këto të fundit për ruajtje dhe administrim në

arkivat shtetërore, ne përputhje me nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji, te sistemuara dhe te inventarizuara, sipas rregullave te përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Bashke me dokumentet dorëzohen:

a) dy kopje te inventarit;

b) një kopje inventari ne regjistrim te numerizuar, qe përputhet me programin e informatizimit te aktivitetit, ku dorëzohen dokumentet.

Neni 43

Dorëzimi i dokumenteve te institucioneve shtetërore ne arkivat përkatës, përshkruar sipas nenit 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji, behet sipas këtyre afateve normative:

a) dokumentet administrative dorëzohen pasi te kenë kaluar 10 vjet nga data e krijimit te tyre. Ky afat është i detyrueshëm edhe për dokumentet ne figure, ne zë e ne lëvizje, qe përbejnë dokumente administrative;

b) dokumentet tekniko-shkencore dorëzohen pas mbarimit te nevojave për shërbim operativ, por jo me vone se 25 vjet nga viti i krijimit te tyre;

c) dokumentet ne figure, ne zë e ne lëvizje dorëzohen pasi te kenë kaluar 15 vjet nga data e krijimit te tyre;

ç) regjistrat e akteve te gjendjes civile dorëzohen pasi te kenë kaluar 75 vjet nga data e krijimit te tyre;

d) dokumentet e klasifikuara "sekret shtetëror" dorëzohen pas deklasifikimit te tyre. Deklasifikimi behet nga autoriteti klasifikues.

Neni 44

Dokumentet e institucioneve qendrore e vendore te administratës shtetërore dorëzohen ne rrjetin shtetëror te arkivave drejtpërdrejt nga institucioni qe i ka krijuar.

Neni 45

1. Arkivat e institucioneve qendrore e vendore te administratës shtetërore, qe e mbyllin veprimtarinë e tyre për çfarëdo lloj shkak, dorëzohen menjëherë pranë arkivave përkatës, sipas nenit 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji.

2. Kur funksionet ose atributet e një institucioni shtetëror barten ligjërisht te një institucion tjetër, ky i fundit mund te administroje dokumentet e trashëguara deri ne mbushjen e afateve te parashikuara ne nenin 43 te këtij ligji.

Neni 46

1. Institucionet arkivore shtetërore te përshkruara ne nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji kane te drejte te tërheqin para afatit normativ dokumentet e krijuara prej institucioneve te administratës shtetërore qendrore e vendore, ne rast rreziku te dukshëm dëmtimi a zhdukjeje fizike.

2. Ne këtë rast, si dhe kur veprimtaria e një institucioni shuhet, shpenzimet për përpunimin arkivor te dokumenteve përballohen nga institucioni fondkrijues, kur ky ekziston, ose nga institucioni i burimit te varësisë.

Neni 47

Dokumentet e subjekteve joshtetore, te personave juridike e fizike private, si dhe ato te personaliteteve shkencore, politike, kulturore, te krijuara jashtë përgjegjësive te tyre shtetërore, te shpallura me interes historik kombëtar, dorëzohen ne arkivat shtetërore me vullnetin e tyre ose te trashëgimtarëve, me marrëveshje

Neni 48

Arkivat e përshkruar ne nenin 9 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" te këtij ligji janë te vetmet institucione shtetërore qe kane te drejtën e blerjes dhe te administrimit te trashëgimisë dokumentare dhe te dorëshkrimeve.

Neni 49

1. Studiuesit dhe punonjësit shkencore, qe bëjnë kërkime për projekte te institucioneve arkivore, kërkimore-shkencore shtetërore ne arkiva te vendeve te tjera dhe marrin prej tyre dokumente, janë te detyruar t'i dorëzojnë ato ne arkivin e institucionit ku punojnë, si dhe te dërgojnë ne arkivat shtetërore përkatës një relacion me përshkrime te hollësishme për sasinë dhe përmbajtjen etyre.

2. Ne këto raste, studiuesit dhe punonjësit shkencore kane te drejtën e një kopjeje falas te dokumenteve. Kopja u ofrohet nga arkivi pranues.

Neni 50

Institucionet joshtetore, personat juridike e fizike private qe dhurojnë, lënë ne trashëgim a për ruajtje ose u shesin dokumente arkivave shtetërore, gëzojnë te drejtën për te marre, sipas marrëveshjes, riprodhime falas te tyre.

Neni 51

Ne rast te ndryshimeve ne organizimin administrativo-territorial, te riorganizimit te veprimtarisë se organeve shtetërore, njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ose arkivat shtetërore, te përshkruar ne nenin 9 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" te këtij ligji, për te vendosur për administrimin e mëtejshëm te dokumenteve.

Neni 52

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare ne pronësi a zotërim te subjekteve joshtetore dhe personave juridike e fizike private, kur këto e shuajnë veprimtarinë e tyre ose nuk kane trashëgimtarë te njohur me ligj, depozitohen ne arkivat shtetërore.

KREU VII KOMUNIKIMI DHE SHFRYTEZIMI I DOKUMENTEVE TE FONDIT ARKIVOR KOMBETAR

Neni 53

1. Shërbimi arkivor garanton te drejtën për t'u njohur me dokumentet qe dëshmojnë veprimtarinë e administratës shtetërore.

2. Personi dhe institucionet janë te barabarte ne te drejtën për shërbim arkivor.

3. Fondkrijuesit gëzojnë te drejtën e shfrytëzimit te dokumenteve ne çdo kohe, pavarësisht nga afatet e përcaktuara ne nenin 61 te këtij ligji.

4. Fondkrijuesit joshteterore kane te drejtën e kufizimit te shërbimit me dokumentet e tyre ne afate te ndryshme nga ato te përcaktuara ne nenin 61 te këtij ligji.

Neni 54

1. Shërbimi arkivor ofrohet pa autorizim.
2. Shfrytëzimi i arkivave shtetërore e private u ofrohet kërkuesve, pavarësisht nga kombësia, shtetësia, statusi ose funksioni i tyre.
3. Autoriteti arkivor shtetëror, kur është e nevojshme, ofron vetëshërbim.

Neni 55

Kërkuesi i një dokumenti nuk është i detyruar te paraqesë arsye për t'u lejuar qe ta shfrytëzojë atë.

Neni 56

Kërkesa për shfrytëzim dokumentesh mund te mos pranohet nëse shërbimi për to është i kufizuar me ligj.

Neni 57

Nëse një arkiv nuk e ka dokumentin e kërkuar, kur është e mundshme, i tregon kërkuesit se ne cilin arkiv ose autoritet publik ndodhet.

Neni 58

Punonjësit e rrjetit arkivor kombëtar shërbejnë dokumentet besnikërisht me origjinalin, pa komente ose interpretime.

Neni 59

Mjetet e informacionit dhe te kërkimit arkivor janë te hapura. Shërbimi i tyre nuk mund t'i kufizohet askujt.

Neni 60

Shfrytëzimi i dokumenteve te fondit arkivor kombëtar behet sipas kërkesave te këtij ligji, nëpërmjet:

- a) shërbimit te dokumenteve ose riprodhimeve te tyre (mikrofilma, fotokopje) për studim ne sallat e leximit te arkivave;
- b) botimit te udhërrëfyesve, katalogëve, inventarëve, si dhe përmbledhjeve me dokumente;
- c) përgatitjes dhe hapjes se ekspozitave dokumentare. Ekspozimi i dokumenteve origjinale lejohet vetëm kur sigu rohet ruajtja fizike dhe teknologjike, sipas rregullave ne fuqi;
- ç) publikimit ne organet e shtypit, radios, medias, multimedias dhe kinematografisë;
- d) dhënies se burimeve institucioneve shtetërore e joshteterore për problemet qe u interesojnë;
- dh) te gjitha formave te promocionit te vlerave kulturore qe ruhen ne arkiva;
- e) shërbimit te numerizuar ne distance.

Neni 61

1. Dokumentet e publikuara një here janë lirisht te shfrytëzueshme.

2. Dokumentet qe administrohen ne institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kane kaluar 25 vjet nga data e krijimit.

Neni 62

Dokumentet qe përmbajnë te dhëna te rëndësishme për sigurimin e interesave te larte te shtetit, qe janë pranuar ne arkivat shtetërore para hyrjes ne fuqi te këtij ligji dhe nuk janë deklasifikuar ende, jepen për shfrytëzim, sipas kërkesave te ligjit nr. 8457, date 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

Neni 63

Arkivat mbrojnë jetën intime te personit. Ndalohet njohja, shfrytëzimi dhe publikimi i dokumenteve qe përmbajnë te dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën private te personit. Dokumentet qe përmbajnë te dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën intime te personit, shërbehen vetëm pasi kane kaluar, sipas rastit, 50 deri ne 150 vjet nga data e krijimit te tyre.

Neni 64

Dokumentet e pronësisë u shërbehen trashëgimtarëve te pronës, përfaqësuesve te tyre ligjore dhe institucioneve shtetërore, qe kane kompetenca vendimmarrëse te njohura me ligj për trashëgimin e pronave.

Neni 65

1. Institucionet publike ne veprim, qe kane autoritet klasifikues për arkivat e tyre dhe institucionet arkivore, qe kane trashëguar informacion te klasifikuar, mund te kufizojnë pjesërisht shfrytëzimin e dokumenteve arkivore, ne përputhje me ligjin nr.8457, date 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

2. Kufizime mund te zbatohen edhe ne funksion:

- a) te mbrojtjes se sigurisë kombëtare dhe te normalitetit ne marrëdhëniet me jashtë;
- b) te interesave te sigurimit publik;
- c) te fshehtësisë për hetimin dhe ndjekjen e veprimtarive kriminale;
- ç) te respektimit te interesave tregtare dhe te barazisë ne konkurrence;
- d) te moscenimit te barazisë se palëve ne një konflikt;
- dh) te mbrojtjes se ekosistemeve natyrore;
- e) te sigurisë se misioneve mbikëqyrëse, si dhe te kushteve për inspektim dhe kontroll nga administrata;
- ë) te mosdemtimit te politikës financiare, monetare dhe tatimore te shtetit;
- f) te respektimit te mirëbesimit ne vendimmarrje brenda ose ndërmjet autoriteteve publike, për përgatitjen e një dosjeje;
- g) te interesave te tjerë te individit, qe vlerësohen te ligjshëm nga institucionet e specializuara.

Neni 66

Shfrytëzimi i dokumenteve arkivore mund te lejohet edhe për rastet e parashikuara ne nenin 65, nëse një interes publik me i larte e përlijg hapjen.

Neni 67

1. Leje për shfrytëzim të parakohshëm të dokumenteve, që u kufizohet shërbimi në nenet 61, 62 dhe 63 të këtij ligji, jepen përkatësisht:

a) nga fondkrijuesi;

b) nga autoriteti klasifikues, për dokumentet e klasifikuara "sekret shtetëror";

c) nga vete personi, për dokumentet që përmbajnë të dhëna intime dhe që kanë të bëjnë me dinjitetin personal të tij.

2. Te drejtën e përjashtimit e kanë, gjithashtu:

a) Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, për dokumentet që ndodhen në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në arkivat shtetërore të qarqeve, pas marrjes së pëlqimit me shkrim të fondkrijuesit, kur ai ekziston;

b) drejtuesi i institucionit, për dokumentet që ruhen në arkivat e sistemit ose në arkivat që administrojnë dokumente të së njëjtës tipologji;

c) çdo subjekt i autorizuar me ligj.

Neni 68

1. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, rrjeti arkivor në varësi të saj dhe çdo njësi e shërbimit arkivor pranë institucioneve të administratës shtetërore, qendrore e vendore, nuk kanë autoritet klasifikues mbi dokumentet që ruajnë e administrojnë.

2. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave bën deklasifikimin e dokumenteve të klasifikuara "sekret shtetëror", që ka trashëguar, sipas përgjegjësisë që i njeht ligji nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 69

Mjetet e informimit dhe të kërkimit arkivor bëjnë të ditur tërësinë e fondeve të dokumenteve të arkivave. Ato njoftojnë edhe për ekzistencën e dokumenteve të klasifikuara "sekret shtetëror", por pa deklaruar përmbajtjen e të dhënave të mbrojtura nga ligji.

Neni 70

1. Kur shfrytëzimi i një dokumenti arkivor është miratuar, shërbimi arkivor autorizon këshillimin e tij në njërin nga format e ruajtjes (mikrofilm, riprodhim dhe origjinal) ose dhënien e kopjeve të certifikuara të tij. Shërbimi arkivor mban parasysh, brenda mundësive, zgjedhjen e kërkuesit për shërbim.

2. Fotokopje ose riprodhime në formë të tjera jepen për të ilustruar botimet, për përgatitje ekspozitash, si dhe për shërbime të tjera të ligjshme.

Neni 71

1. Kërkuesi ka të drejtë të njihet me një arsye ligjore për mospranimin e shërbimit, duke përfshirë rastin e dokumentacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".

2. Kërkuesi ka të drejtë të kërkojë autorizim nga autoriteti klasifikues për t'u njohur me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

3. Autoriteti klasifikues mund të lejojë njohjen e pjeshme, si rrjedhim, fshehjen e pjeshmete informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror". Kërkuesi vihet në dijeni për këtë.

Neni 72

Kërkuesi, te cilit nuk i pranohet shërbimi për dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror", ka te drejtën e ankimit në gjykatë ose përpara çdo organi tjetër të paanshëm të parashikuar me ligj.

Neni 73

Shërbimi arkivor nuk është i detyruar të japë për shfrytëzim një dokument të botuar ose që është lehtësisht i shfrytëzueshëm në burime të tjera.

Neni 74

1. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike krijuese të dokumenteve janë të detyruara:

- a)** të vënë në dijeni publikun për të drejtën për të shfrytëzuar dokumentet arkivore dhe për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte;
- b)** të sigurojnë ushtrimin e kësaj të drejte në dobi të interesave të shtetasve;
- c)** të kualifikojnë nëpunësit e tyre, për të kryer detyrat dhe detyrimet për zbatimin e kësaj të drejte.

2. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike kanë për detyrë:

- a)** të bëjnë përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të tyre, duke i bërë lehtësisht të shfrytëzueshme;
- b)** të zbatojnë procedurën të qarta për asgjësimin e dokumenteve pa vlerë ruajtjeje.

Neni 75

Autoritetet publike, me nismën e tyre, bëjnë të njohura burimet që kanë në dispozicion, në funksion të transparencës së veprimtarisë të administratës shtetërore, në shërbim të nxitjes së pjesëmarrjes të publikut në çështje me interes për të dhe në funksion të forcimit të shtetit të drejtës dhe të mirëqeverisjes.

Neni 76

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore bëjnë përpjekje të bashkërenduara, mutatis mutandis, për të lehtësuar kushtet e komunikimit të arkivave private me arkivat publike.

Neni 77

1. Kërkesat e institucioneve shtetërore e joshitetore, si dhe të personave juridike e fizike private, për studime joshkencore, të dhëna arkivore, kopje ose ekstrakte dokumentesh, që ruhen në arkivat shtetërore, plotësohen kundrejt pagesës, sipas tarifave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2. Shërbimi me fotokopje, për dokumente në funksion të studimeve shkencore universitare akademike, bëhet me tarife të diferencuar favorizuese.

Neni 78

1. Sasia e dokumenteve të riprodhuara, që i shërbehen kërkuesit, në bazë të flete-porosisë së tij, përcaktohet nga autoriteti arkivor shërbyes, në përputhje me objektin e kërkesës.

2. Kërkuesit që shtrembëron burimin në përdorimin publik të dokumentit, nuk i shërbehen riprodhime.

Neni 79

1. Kur subjektet joshiteterore, personat juridike e fizike private, pronare ose zotërues a mbajtës të dokumenteve, nuk respektojnë detyrimet e parashikuara nga ky ligj, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përcakton një afat kushtetues, për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore. Nëse detyrimet nuk plotësohen brenda afatit kushtetues, dokumentet e tyre merren për ruajtje nga arkivat shtetërore.
2. Në rast se shërbimi arkivor kombëtar vlerëson se ekziston rreziku i dëmtimit të menjëhershëm, që mund të sjellë zhdukje të dokumenteve, ato merren në administrim pa lënë afat kushtetues.
3. Në të dyja rastet ruhet e drejta e pronësisë dhe e rikthimit të dokumenteve.

KREU VIII EKSPORTIMI DHE IMPORTIMI I DOKUMENTEVE

Neni 80

1. Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që ruhen në arkivat shtetërore ose private paraqiten në mjedise ndërkombëtare, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllime manifestimi, ekspozimi ose promovimi kulturor, si dhe për qëllime historike e shkencore, vetëm kur garantohet me marrëveshje ruajtja e integritetit dhe siguria e tyre fizike, në udhëtim dhe në kohën e veprimtarisë.
2. Vlera e sigurimit përcaktohet me marrëveshje, sipas standardeve ndërkombëtare, nga autoritetet e parashikuara në nenet 82 dhe 83 të këtij ligji.

Neni 81

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që pësojnë dëmtime gjatë transportit ose për shkak të mikromjedisit, ku do të vendosen gjatë ekspozimit, nuk lejohet të paraqiten në mjedise ndërkombëtare.

Neni 82

Leja për paraqitjen e dokumenteve të fondit arkivor kombëtar në mjedise ndërkombëtare jepet:

- a) për dokumentet që ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërore vendore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
- b) për dokumentet që ruhen në arkivat shtetërore të sistemit dhe arkivat që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji, nga drejtuesit e institucioneve të varësisë përkatëse;
- c) për dokumentet që ruhen nga arkivat private, nga Këshilli i Lartë i Arkivave.

Neni 83

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që përbejnë vlera unikale të trashëgimisë kulturore kombëtare, të përcaktuara si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, paraqiten jashtë shtetit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 84

Autoritetet, që kanë të drejtë për dhënie leje për paraqitjen e dokumenteve të fondit arkivor kombëtar në mjedise ndërkombëtare, sipas neneve 82 dhe 83 të këtij ligji, janë të detyruara të

përcaktojnë datën e sakte të rikthimit të tyre në vendruajtjen e përhershme. Koha e qëndrimit jashtë shtetit nuk mund të jetë më shumë se një vit nga data e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Neni 85

Ne rastin e lejimit të daljes së përkohshme të dokumenteve të fondit arkivor kombëtar jashtë territorit shtetëror, institucioni miratues është i detyruar t' i shoqërojë ato me lejet përkatëse për autoritetet doganore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 86

1. Importimi i dokumenteve për pasurimin e arkivave të Shqipërisë bëhet sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga palët bashkëpunuese.
2. Pasuritë arkivore, që hyjnë në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë përmes importit, shoqërohen me certifikatën që përcakton identitetin dhe prejardhjen e tyre dhe me lejen e autoritetit dërgues.

Neni 87

Shteti shqiptar, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ka detyrimin të interesohet e të kërkojë rikthimin në vend të dokumenteve të fondit arkivor kombëtar, që kanë dale në mënyrë të paligjshme jashtë territorit shtetëror.

Neni 88

1. Kur në territorin e Republikës së Shqipërisë vihet re se ka dokumente të një shteti tjetër, të hyra në rrugë të paligjshme, këto kalojnë në ruajtje të përkohshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
2. Nëse brenda pesë vjetëve, pas publikimit të ekzistencës së këtyre dokumenteve, nuk paraqiten kërkesa për rikthimin e tyre në vendin e prejardhjes, ato kalojnë në pronësi të shtetit shqiptar.

KREU IX ARKIVISTI

Neni 89

Punonjësi i rrjetit arkivor kombëtar të Republikës së Shqipërisë respekton Kodin Deontologjik Ndërkombëtar të Arkivisteve.

Neni 90

Arkivistet e rrjetit arkivor shtetëror nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Përgjegjësia e tyre si ruajtës të trashëgimisë dhe të informacionit rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe përcaktohet nga ligjet në fuqi.

Neni 91

Arkivistet janë të paanshëm në ofrimin e shërbimit për shfrytëzimin e dokumenteve dhe respektojnë kufizimin ligjor për mbrojtjen e të dhënave të jetës private të individit dhe të interesave të veçante të shtetit, pavarësisht se mund të njihen me to për shkak të detyrës.

KREU X KUNDERVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Neni 92

1. Autoritetet dhe punonjësit e arkivave shtetërore mbajnë përgjegjësi ligjore për shkeljen e kërkesave të këtij ligji. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbejnë veprë penale, përbejnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobe nga 1 deri në 5 paga mujore shkeljet e mëposhtme:

a) mungesa e kushteve të nevojshme të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve;

b) moszbatimi i kërkesave të këtij ligji dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve;

c) mosdorëzimi në afat dhe sipas kërkesave të këtij ligji i dokumenteve në arkivat shtetërore;

ç) mosdhënia e të dhënave të nevojshme për regjistrimin dhe evidencimin e veprimtarisë arkivore e të dokumenteve të tyre arkivave shtetërore, të përcaktuar me ligj;

d) pengimi i punonjësve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për të kryer përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji.

2. Shkeljet që kanë të bëjnë me tjetërsimin e dokumenteve dhe humbjen e dokumenteve të arkivit nga persona që i kanë në administrim, kur ato nuk janë kopje e vetme, dënohen me gjobe nga 2 deri në 10 paga mujore.

3. Personat fizike e juridike private i nënshtrohen gjobës nga 100 mijë deri në 300 mijë leke kur kanë kryer shkeljet e përmendura në shkronjat "a", "ç", "d" të pikës 1 dhe pikën 2 të këtij neni.

4. Gjoha vendoset nga punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

5. Për botimin e burimeve arkivore në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, mbajnë përgjegjësi edhe kërkuesit. Kërkuesi që shkel në mënyrë të përsëritur rregulloren e shfrytëzimit të dokumenteve arkivore, ose dëmton vetë dokumentet, mund të përjashtohet për një periudhë deri 1-vjeçare nga e drejta e shërbimit arkivor.

6. Kundër vendimit të dënimit me gjobe ose të përjashtimit, personat që kanë kryer shkeljet mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

7. Asgjësimi i dokumenteve, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, vjedhja, si dhe humbja e dokumenteve të shpallura të një rëndësie të veçante, kur shkelja përbejnë veprë penale, dënohet sipas Kodit Penal.

KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 93

1. Masat për mbrojtjen e dokumenteve në kohë të veçante rrjedhin nga ligji nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile".

2. Rregullat e zhvendosjes (evakuimit), të shmangies dhe të risistemimit të dokumenteve në kohë të veçante përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 94

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenëve 9 pika 3, 14 pika 5, 15 pika 2, 25 pika 1, 36 pika 2, 83 dhe 93 pika 2 të këtij ligji.

VENDIM

Nr.390, datë 6.8.1993

PER RREGULLAT E PRODHIMIT, ADMINISTRIMIT, KONTROLLIT DHE RUAJTJEN E VULAVE ZYRTARE

V E N D I M

Me qëllim që të krijohet një regjim i fortë në prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në Republikën Shqipërisë detyrohen të kenë vulën e tyre zyrtare prej gome ose plastike me simbolet dhe shënimet e nevojshme identifikuese.
2. Vula zyrtare e personave juridikë shtetërorë duhet të ketë diametrin 30 mm. Në qendër vendoset stema dhe rreth saj shkruhet "Republika e Shqipërisë" e shënimet e nevojshme për identifikimin e personit juridik.
3. Personat juridikë të lejuar posaçërisht nga Këshilli i Ministrave, kanë të drejtë që përveç vulës prej gome ose plastike të mbajnë në një ose më shumë ekzemplarë edhe vulë metalike (vulë e thatë).
4. Vulat prodhohen në punishte të posaçme shtetërore ose private që caktohen dhe pajisen me licencë nga Ministria e Rendit Publik. Punishtja duhet të jetë e siguruar me roje të armatosura. Rregullat për pajisjen me licencë caktohen nga Ministria e Rendit Publik.
5. Prodhimi i vulave bëhet në një ekzemplar të vetëm, të dhënat e të cilëve regjistrohen në kompjuterin e Ministrisë së Rendit Publik. Bëhet përjashtim nga ky rregull në rastet kur veprimtaria e personit juridik ushtrohet në më shumë se një zyrë sekretarie si dhe kur parashikohet me dispozita të veçanta.
6. Personat juridikë për t'u pajisur me vulë zyrtare duhet të paraqesin kërkesën me shkrim dhe modelin përkatës, të cilat i dërgohen drejtpërdrejt punishtes së caktuar nga Ministria e Rendit Publik.
7. Vulat zyrtare shtetërore ruhen në zyrat sekrete. Atje ku nuk ka të tilla ruhen në kasaforta metalike të siguruar me çelës.
8. Nuk lejohet përdorimi në dokumente i vulave që për shkak të përdorimit të gjatë të tyre janë bërë të palexueshme. Ato asgjësohen me procesverbal. Kur vula humbet mbahet procesverbal dhe njoftohen menjëherë organet e rendit publik.
9. Ndalohet përdorimi në dokumente i vulave që nuk kanë emërtime të sakta, vendosja e tyre në dokumente të nënshkruara nga persona jo kompetentë, dhënia e vulës për përdorim personave të pa autorizuar, nxjerrja jashtë objekteve të përcaktuara si dhe lënia pa siguruar e tyre.

10. Për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Ministria e Rendit Publik.

11. Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 25.7.1978 "Për vulat zyrtare dhe aparatet shumëzuese për botim" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr.761, date 19.11.2004
PER KRIJIMIN E ARKIVIT QENDROR PER SISTEMIMIN, RUAJTJEN DHE
SHFRYTEZIMIN E DOKUMENTACIONIT TE PERIUDHES SE SIGURIMIT
PRANE INSTITUTIT TE SIGURIMEVE SHOQERORE

I azhurnuar me:

- ***Udhëzimin nr.727, datë 28.05.2008***

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te pikave 2 shkronja "c" e 3 te nenit 9 te ligjit nr.9154, date 6.11.2003 "Për arkivat", me propozimin e Ministrit te Punës dhe te Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit te periudhës se sigurimit, pranë Institutit te Sigurimeve Shoqërore.

Rrjeti i këtij arkivi te shtrihet ne drejtoritë rajonale te sigurimeve shoqërore.

2. Drejtoritë rajonale te sigurimeve shoqërore te mbledhin, brenda dates brenda datës 30.4.2009.

dokumentacionin e periudhës se sigurimit për ndërmarrjet dhe institucionet, buxhetore e jobuxhetore, qe kane ndërprerë veprimtarinë, si dhe për ndërmarrjet qe, për arsye te reformës, ushtrojnë veprimtari te kufizuar.

3. Ndërmarrjet dhe institucionet, buxhetore e jobuxhetore, qe do ta mbyllin veprimtarinë apo do ta kufizojnë atë pas datës 30.6.2005, detyrohen te dorëzojnë dokumentacionin e periudhës se sigurimit te punonjësve te tyre ne drejtoritë rajonale te sigurimeve shoqërore.

4. Ne këtë dokumentacion përfshihen regjistrat themeltare, listepagesat dhe çdo dokument tjetër qe ka lidhje me periudhën e sigurimit ose prej te cilave burojnë te drejta nga sigurimet shoqërore.

5. Regjistrat themeltare te dorëzohen ne drejtoritë rajonale te sigurimeve shoqërore pasi dokumentacioni i periudhës se sigurimit te punonjësve te jete përditësuar plotësisht, duke përputhur listepagesat me regjistrat themeltare dhe librezat e punës. Regjistrat themeltare te mbyllen për çdo person.

Drejtoritë rajonale te sigurimeve shoqërore, para marrjes ne dorëzim te këtij dokumentacioni, te numërtojnë, kontrollojnë dhe konfirmojnë saktësinë për çdo flete te regjistrave themeltare te vjetërsisë ne pune.

6. Ndërmarrjet qe zhvillojnë veprimtari te kufizuar, para se te dorëzojnë dokumentet e periudhës se sigurimit, ku është e gjithë periudha e punës, qe nga krijimi, te hapin regjistra themeltare te rinj vetëm për punonjësit qe kane ne pune.

7. Instituti i Sigurimeve Shoqërore te marre te gjitha masat për marrjen ne dorëzim te dokumentacionit te periudhës se sigurimit nga fondkrijuesit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave te Shtetit për sistemimin dhe ruajtjen e këtij dokumentacioni.

8. Dokumentacioni i periudhës se sigurimit te punonjësve te ndërmarrjeve shtetërore, ish-kooperativave bujqësore, institucioneve, i cili deri me tani është administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, te dorëzohet brenda datës brenda datës 30.4.2009 pranë strukturave te rrjetit te arkivit qendror te dokumenteve te periudhës se sigurimit.

9. Ngarkohen ministrinë qe kane ne varësi subjektet e përcaktuara ne këtë vendim, Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave te ndjekin procedurat për kalimin ne përgjegjësi

administrimi te Institutit te Sigurimeve Shoqërore te mjediseve te gatshme, ku ndodhet dokumentacioni i periudhës se sigurimit.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore te përcaktojnë një program pune për kalimin e dokumentacionit te periudhës se sigurimit.

12. Vendimi nr.464, date 22.7.1998 i Këshillit te Ministrave "Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit te sigurimit te punonjësve te ish-kooperativave bujqësore, ndërmarrjeve dhe institucioneve qe kane ndërprerë veprimtarinë e tyre ose janë ne procesin e mbylljes" shfuqizohet.

VENDIM
Nr.157, datë 25.3.2005
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË KËSHILLIT TË LARTË TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 94 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Rregullorja e Këshillit të Lartë të Arkivave, miratuar me vendimin nr.398, date 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave "Për miratim rregulloresh", shfuqizohet.
3. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këtij Këshilli, si dhe çdo efekt tjetër financiar që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

RREGULLORE
PËR KËSHILLIN E LARTË TË ARKIVAVE

Neni 1
Baza ligjore

Këshilli i Lartë i Arkivave (më tej: KLA) formohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë (më tej: DPA), në mbështetje të nenit 14 pika 1 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2004 "Për arkivat".

Neni 2
Përkufizim

KLA është organizëm ndërinstitucional vendimmarrës. Përbërja, detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me këtë rregullore.

Neni 3
Përbërja e KLA-së

KLA-JA përbëhet nga 17 anëtarë, 8 të brendshëm dhe 9 të jashtëm. Anëtarë të brendshëm janë përfaqësuesit e zgjedhur nga radhët e specialistëve dhe të punonjësve të rrjetit arkivor shtetëror që administrohet nga vetë DPA-ja. Anëtarë të jashtëm të KLA-së janë ata që përfaqësojnë institucione të tjera, të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 4
Anëtarët e brendshëm të KLA-së

Anëtarët e brendshëm të KLA-së caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, me propozim dhe të Drejtorit të Drejtorisë së Inspektim-Kontrollit dhe të zëvendësdrejtorit të Arkivit Qendror Shtetëror (më tej AQSH)

Drejtorët e drejtorive të DPA-së janë anëtarë të KLA-së për shkak të detyrës.

Në zgjedhjen e anëtarëve të brendshëm të KLA-së, ruhen përpjesëtimet e përfaqësimit në shkallë qendrore dhe vendore, në raportin 3 me 1.

Neni 5 Anëtarët e jashtëm të KLA-së

Anëtarët e jashtëm të KLA-së caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë, si mëposhtë:

- Tre përfaqësues të Akademisë së Shkencave ose të institucioneve në varësi të saj;
- Dy përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe/ose të institucioneve në varësi të saj;
- Dy përfaqësues të Universitetit të Tiranës;
- Dy përfaqësues të arkivave të sistemit. Këta të fundit zgjidhen me votim të fshehtë, nga mbledhja e drejtorëve të tyre.

Neni 6 Shpallja e përbërjes

Përbërja e KLA-së shpallet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, pas zgjedhjes së anëtarëve të brendshëm dhe caktimit të anëtarëve të jashtëm. Mbledhja e parë e KLA-së bëhet jo më vonë se një muaj nga data e shpalljes së përbërjes nominale të tij. Në mbledhjen e parë bëhet zgjedhja e sekretarit.

Neni 7 Kryetari

Kryetar i KLA-së është Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës të mbledhjes së KLA-së, drejton mbledhjen dhe nënshkruan vendimet e saj.

Neni 8 Sekretari

Sekretari i KLA-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtar i KLA-së që ka specializim në fushë të arkivave dhe ushtron funksionin e inspektorit të përgjithshëm pranë DPA-së. Sekretari ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KLA-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

Neni 9 Mbledhja e KLA-së

Mbledhja e KLA-së mbahet kur është e pranishme shumica e anëtarëve dhe jo më pak se tri herë në vit. Rendi i ditës dhe aktet për diskutim vihen në dispozicion të anëtarëve të KLA-së jo më vonë se një javë para datës së mbledhjes.

Rendi i ditës hartohet nga sekretari i KLA-së dhe miratohet nga kryetari. Procesverbali i mbledhjes mbahet sipas ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16. Një e treta e anëtarëve të KLA-së kanë të drejtë të kërkojnë thirrjen e mbledhjes së KLA-së. Çdo anëtar i KLA-së ka të drejtë të bëjë propozime për ndryshime e shtesa në rendin e ditës. Propozimet miratohen apo/ose kundërshtohen me votimin e shumicës së thjeshtë të pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 10

Vlefshmëria evendimmarrje

Vendimet e KLA-së janë të vlefshme nëse fitojnë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Votimi kundër i anëtarit të KLA-së duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim. Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 11

Detyrat e KLA-së

KLA miraton paraprakisht të gjitha aktet që kanë të bëjnë me strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të shërbimit arkivor dhe ua propozon për miratim përfundimtar, kur e kërkon ligji, organeve më të larta.

KLA harton dhe shqyrton paraprakisht projektaktet ligjore dhe nënligjore që DPA u propozon institucioneve ligjvënëse dhe ekzekutive për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor kombëtar.

KLA miraton paraprakisht rregulloret që hartohen në zbatim të ligjit nr.9154, date 6.11.2003 "Për arkivat" që DPA i propozon Këshillit të Ministrave për miratim:

- a) Rregulloren e Këshillit të Lartë të Arkivave;
- b) Rregulloren e Komisionit Qendror të Ekspertizës;
- c) Rregulloren e Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror";
- d) Rregulloren e Komisionit të Përhershëm të Ekspertëve të vlerësimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare. KLA miraton "Listën tip të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare", të njësuar në shkallë vendi.

KLA miraton rregullat tekniko-profesionale dhe metodologjike të punës me dokumentet (administrative, tekniko-shkencore, në figurë, në zë, në lëvizje, në formë të numerizuar).

KLA miraton programet e kualifikimit profesional të punonjësve të shërbimit arkivor kombëtar.

KLA miraton raportin e analizës vjetore të DPA-së.

KLA shqyrton dhe miraton paraprakisht projektbuxhetin vjetor të DPA-së.

KLA miraton projektet botuese të DPA-së, kur kjo e fundit paraqitet si ent botues.

KLA miraton marrëveshjen tip të bashkëpunimit me institucionet e ngjashme me jashtë, në përputhje me ligjin nr.8371, datë 8.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" .

Neni 12

Kohëzgjatja e mandatit

Anëtarët e KLA-së zgjidhen/emërohen për një periudhë trevjeçare me të drejtën e rizgjedhjes. Në përfundim të mandatit të KLA-së përcaktohet përbërja e re, sipas përshkrimit në nenet 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje. Mandati i anëtarëve të KLA-së mbaron nga mospjesëmarrja pa arsye në dy mbledhje radhazi.

Neni 13

Shpërblimi

Anëtarët e KLA-së, në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 14 pika 1 dhe 5, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mbledhje në masën 5 mijë lekë. Kryetari

shpërblehet me 7 mijë lekë për çdo mbledhje. Shpërblimi jepet vetëm në rastet e pjesëmarrjes në mbledhje.

VENDIM
Nr. 158, datë 25.3.2005
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË KOMISIONIT QENDROR TË EKSPERTIZËS, PRANË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 94 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Komisionit Qendror të Ekspertizës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, që i bashkë lidhet këtij vendimi.
2. Rregullorja e Komisionit Qendror të Ekspertizës, miratuar me vendimin nr. 398, date 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave "Për miratim rregulloresh", shfuqizohet.
3. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këtij Komisioni, si dhe çdo efekt tjetër financiar që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RREGULLORE
PËR KOMISIONIN QENDROR TË EKSPERTIZËS

Neni 1
Baza ligjore

Komisioni Qendror i Ekspertizës (më tej KQE) formohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (më tej DPA) në mbështetje të nenit 14 pika 1, 3 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

Neni 2
Përkufizim

KQE është organizëm ndërinstytucional vendimmarrës. Përbërja, detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me këtë rregullore.

Neni 3
Përbërja e KQE-së

KQE-ja përbëhet nga 15 anëtarë, 7 të brendshëm dhe 8 të jashtëm. Anëtarët e brendshëm janë specialistë me përvojë në fushën e arkivistikës, në rrjetin arkivor që administrohet nga DPA-ja. Anëtarë të jashtëm të KQE-së janë punonjës shkencorë e specialistë të institucioneve të tjera, të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 4
Anëtarët e brendshëm të KQE-së

Anëtarët e brendshëm të KQE-së caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Ata përzgjidhen nga arkivistët që kanë përvojë pune në shërbimin arkivor mbi 10 vjet.

Neni 5 **Anëtarët e jashtëm të KQE-së**

Anëtarët e jashtëm të KQE-së caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë si më poshtë:

- Një përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Një përfaqësues i Institutit të Statistikës;
- Një përfaqësues i Arkivit Qendror Teknik;
- Një përfaqësues i Arkivit Qendror të Filmit;
- Dy përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe/ ose institucioneve në varësi të saj.
- Dy përfaqësues të arkivave të sistemit, që zgjidhen nga mbledhja e drejtorëve të tyre, me votim të fshehtë.

Neni 6 **Shpallja e përbërjes**

Përbërja e KQE-së shpallet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, pas zgjedhjes/emërimit të anëtarëve të jashtëm dhe atyre të brendshëm. Mbledhja e parë e KQE-së bëhet jo më vonë se një muaj nga data e shpalljes së përbërjes.

Neni 7 **Kryetari**

Kryetari i KQE-së është Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës dhe drejton mbledhjet e KQE-së.

Neni 8 **Sekretari**

Në mbledhjen e parë bëhet zgjedhja e sekretarit. Sekretari zgjidhet me dy të tretat e votive të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Për funksionin e sekretarit kandidojnë vetëm anëtarët e brendshëm të KQE-së, që ushtrojnë detyrën e inspektorit të përgjithshëm.

Sekretari drejton mbledhjet e KQE-së në mungesë dhe me urdhër të kryetarit.

Neni 9 **Mbledhja e KQE-së**

KQE mblidhet kur është e pranishme më shumë se gjysma e anëtarëve.

KQE mblidhet jo më pak se një herë në vit.

Rendi i ditës dhe materialet e mbledhjes vihen në dispozicion të anëtarëve të KQE-së jo më vonë se dhjetë ditë para mbledhjes.

Rendi i ditës propozohet nga sekretari dhe miratohet nga kryetari i KQE-së. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga sekretari i KQE-së. Materialet e mbledhjes shoqërohen me relacion shpjegues. Në mbledhjet kur KQE-ja ushtron kompetencat e parashikuara në nenin 11/2 të kësaj rregulloreje merr pjesë përfaqësuesi i institucionit fond krijues. Një e treta e anëtarëve të KQE-së kanë të drejtë të kërkojnë thirrjen e mbledhjes së KQE-së. Çdo anëtar i KQE-së ka të drejtë të bëjë propozime për ndryshime e shtesa në rendin e ditës, të cilat miratohen apo/ose kundërshtohen me shumicën e thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 10

Vlefshmëria e vendimmarrjes

Vendimet e KQE-së janë të vlefshme nëse fitojnë shumicën e thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në mbledhjen e saj. Vendimet e KQE-së firmosen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Votimi kundër i anëtarit të KQE-së duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim. Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 11

Detyrat e KQE-së

1. KQE përgatit "Listën-tip" të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare (më tej RHK).
2. KQE miraton listat e dosjeve të veçuara për asgjësim nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore që i dorëzojnë dokumentet pranë Arkivit Qendror Shtetëror, për dokumentet që kanë humbur vlerën e ruajtjes të mëtejsh me.
3. KQE miraton listat e dokumenteve të veçuara për asgjësim nga Arkivi Qendror Shtetëror. Vendimet e KQE-së u dërgohen institucioneve përkatëse dhe zbatimi i tyre ndiqet nga AQSH.

Neni 12

Shpërblimi

Anëtarët e KQE-së, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 14 pika 5, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mbledhje, në masën 5 mijë lekë. Kryetari shpërblehet me 7 mijë lekë për çdo mbledhje. Shpërblimi jepet vetëm në rastet e pjesëmarrjes në mbledhje.

VENDIM
Nr.160, datë 25.3.2005
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË EKSPERTËVE, PRANË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 94 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së organizimit e të funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Ekspertëve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këtij Komisioni, si dhe çdo efekt tjetër financiar që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

RREGULLORE
PËR KOMISIONIN E PËRHERSHËM TË EKSPERTËVE

Neni 1
Baza ligjore

Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve për vlerësimin e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare (më tej Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve-KPE) formohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë (më tej DPA), në mbështetje të nenit 14 pika 1 dhe 5 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat". Detyrat e KPE-së burojnë nga neni 31 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

Neni 2
Përkufizim

KPE-ja është organizëm ndërinstitucional. Përbërja, detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me këtë rregullore.

Neni 3
Përbërja e KPE-së

KPE-ja përbëhet nga specialistë të vlerësimit të trashëgimisë arkivistike kombëtare. KPE-ja formohet si vijon:

- Tre anëtarë të brendshëm emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave.
- Dy anëtarë caktohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe/ose institucionet në varësi të saj.
- Dy anëtarë caktohen nga Akademia e Shkencave dhe/ose institucionet në varësi të saj.
- Dy anëtarë caktohen nga Universiteti i Tiranës. Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave shpall përbërjen e KPE-së. Mbledhja e parë e KPE-së bëhet jo më vonë se një muaj pas shpalljes së përbërjes së tij. Mbledhja e parë thirret nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Në këtë mbledhje bëhet zgjedhja e sekretarit të KPE-së. Kryetar i KPE-së është një përfaqësues i Akademisë së Shkencave, me titull "akademik". Sekretar i KPE-së është një përfaqësues i DPA-së, më përvojë pune në arkiva jo më pak e dhjetë vjet. Ai përgatit lëndën që do të shqyrtojë mbledhja dhe mban procesverbalin e saj.

Neni 4 Qëllimi

KPE-ja i ushtron përgjegjësitë e parashikuara në këtë rregullore vetëm për aktet. që cilësohen "Dokumente me rëndësi historike kombëtare" (më tej RHK).

Neni 5 Detyrat

KPE-ja miraton paraprakisht:

1. "Listën tip" me afatet e ruajtjes së dokumenteve administrative RHK, që i paraqitet nga Komisioni Qendror i Ekspertizës.
2. Shpërndarjen në vendruajtje të fondeve të dokumenteve që administrohen nga DPA-ja. Vendimet që merr KPE-ja sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni miratohen nga Këshilli i Lartë i Arkivave (më tej KLA).
3. Matricën e njësuar të përshkrimit të dokumentit RHK që subjekti joshtetëror privat nxjerr në shitje.
4. Vlerësimin e kushteve të parablerjes nga DPA-ja të këtyre dokumenteve, sipas nenit 31 pika 1 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat". KPE-ja negocion për ushtrimin e kësaj të drejte nga DPA-ja. Në rast se DPA-ja nuk ka mundësi buxhetore të ushtrimit të së drejtës së parablerjes, KPE-ja jep mendimin përkatës për dhënien ose/dhe jo të lejes së tregtimit të lirë të dokumenteve RHK që subjektet joshtetërore private duan të shesin. Mendimi i përcillet DPA-së për të ushtruar të drejtën e vendimmarrjes.
5. Dërgimin dhe/ose moslejimin e nxjerrjes jashtë vendit të dokumenteve RHK në pronësi të shtetit dhe/ose të subjekteve joshtetërore private, në rast se këto dokumente përbëjnë vlera unike në kuadër të trashëgimisë arkivore të vendit, të cilin ia përcjell Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave për bërjen e propozimit për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimit të nenit 83 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".
6. Kushtet e tregtimit të dokumenteve RHK në rast të ndryshimit të pronarit privat. Këto kushte KPE-ja ia propozon DPA-së për ushtrimin e së drejtës së vendimmarrjes. Kjo e fundit mund të kufizojë shitjen e këtyre dokumenteve deri në 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit prej pronarit. Kur KPE-ja nuk arrin të marrë vendim duke u mbështetur vetëm në përshkrimet arkivistike, që të propozojë ndalimin dhe/ose të kushtëzojë shitjen e lirë të dokumenteve RHK në pronësi të subjekteve joshtetërore private, ai ka të drejtë të njihet me vetë dokumentin, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj.
Pronari joshtetëror privat i dokumenteve RHK ka të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
7. Rregullat për paraqitjen e dokumenteve arkivore në mjediset ndërkombëtare, të cilat ia paraqet për miratim përfundimtar Këshillit të Lartë të Arkivave.
8. Listën e pronarëve të arkivave private, që sipas nenit 32 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente të shpallura RHK. Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave miraton vendimet e KPE-së të përshkruara në paragrafët 3, 4, 6 e 8 të këtij neni.

Neni 6

Vlefshmëria e vendimmarrje Vendimet e KPE-së janë të vlefshme nëse miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtareve pjesëmarrës në mbledhje. Votimi

kundër i anëtarit të KPE-ja duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim. Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 7 **Kohëzgjatja e mandatit**

Anëtarët e KPE-së caktohen për një periudhë pesëvjeçare. Në përfundim të mandatit të KPE-së, ripërcaktohet përbërja e tij sipas përshkrimit në nenin

3 të kësaj rregulloreje.

Mandati i anëtarësisë në KPE është i përsëritshëm. Mandati i anëtarësisë në KPE zhvlerësohet vetvetiu nga mospjesëmarrja pa arsye në dy mbledhje radhazi.

Neni 8 **Shpërblimi**

Anëtarët e KPE-së, në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", neni 14 pika 5, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mbledhje, në masën 5 mijë lekë. Kryetari shpërblehet me 7 mijë lekë për çdo mbledhje. Shpërblimi jepet vetëm në rastet e pjesëmarrjes në mbledhje